

# Çfarë është OSBE?



# Cilët jemi



Puna e OSBE-së në terren i mundëson Organizatës të trajtojë krizat që në lindje të tyre. OSBE-ja ka dërguar qindra monitorues në Ukrainë, me qëllim uljen e tensioneve.

Me 57 Shtete pjesëmarrëse nga Amerika e Veriut, Evropa dhe Azia, OSBE-ja – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - është organizata më e madhe e sigurisë rajonale në botë. OSBE-ja punon për të ndërtuar dhe ruajtur stabilitetin, paqen dhe demokracinë për më shumë se një miliard njerëz, përmes dialogut politik dhe projekteve në terren.

OSBE-ja është forum për dialog politik për një gamë të gjerë çështjesh të sigurisë, si dhe platformë për veprim të përbashkët, me qëllim përmirësimin e jetës së individëve dhe komuniteteve. Organizata ndihmon në ngushtimin e dallimeve, në krijimin e besimit dhe rritjen e bashkëpunimit brenda dhe midis shteteve. Aty ku ka paqëndrueshmëri, OSBE-ja punon për të parandaluar konfliktin, për të menaxhuar krizat dhe për të nxitur rehabilitimin pas konfliktit.

Me njësitë e ekspertëve, institucionet dhe operacionet e saj në terren, OSBE-ja trajton çështje me ndikim në sigurinë tonë të përbashkët si kontrolli i armëve, terrorizmi, mirëqeverisja, siguria energjetike, trafikimi i personave, demokratizimi, liria e medias dhe pakicat kombëtare.

# Historia jonë

Zanafilla e OSBE-së daton në fillimin e viteve 1970, me Aktin Final të Helsinkit (1975) dhe krijimin e Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE), e cila shërbeu gjatë Luftës së Ftohtë si një forum i rëndësishëm shumëpalësh për dialog dhe negocim ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit.



Akti Final i Helsinkit, i nënshkruar më 1 gusht 1975, përcaktoi dhjetë parimet themelore ("Dekalogu") që rregullojnë sjelljen e Shteteve ndërmjet njëri-tjetrit dhe kundrejt qytetarëve të tyre. Ky dokument vijon ta udhëheqë punën e OSBE-së edhe sot. (akg-images)

Akti Final i Helsinkit, që u nënshkrua më 1 gusht 1975, përmban një sërë angazhimesh kyçe për çështjet politiko-ushtarake, ekonomike dhe mjedisore dhe të të drejtave të njeriut. Ai, gjithashtu, përcaktoi dhjetë parimet themelore ("Dekalogu"), që rregullojnë sjelljen e Shteteve ndërmjet njëri-tjetrit dhe kundrejt qytetarëve të tyre.

Nga viti 1975 deri në vitet 1980, OSBE-ja, përmes një sërë mbledhjesh dhe konferencash, zgjeroi angazhimet e Shteteve pjesëmarrëse, ndërkohë që periodikisht shqyrtonte zbatimin e tyre. Ajo krijoi një lidhje të qartë mes të drejtave të njeriut dhe sigurisë dhe ishte një ndër kanalet e pakta

të komunikimit mes bllokut të Lindjes dhe Perëndimit, si edhe me shtetet neutrale dhe ato të papozicionuara.

Me fundin e Luftës së Ftohtë, Samiti i Parisit i nëntorit 1990 e futi KSBE-në në një kurs të ri. Në Kartën e Parisit për një Evropë të Re, KSBE-ja u thirr që të luante rolin e vet në menaxhimin e ndryshimeve historike që po ndodhnin në Evropë dhe t'u përgjigjej sfidave të reja në periudhën pas Luftës së Ftohtë. Kjo çoi në ngritjen e strukturave të përhershme, përfshirë sekretariatit dhe institucionet, si edhe dërgimin e operacioneve të para në terren.

Pas ndarjes së ish-Jugosllavisë dhe konflikteve

që pasuan, KSBE-ja ndihmoi në menaxhimin e krizave dhe në rivendosjen e paqes. Po ashtu, ajo punoi me Shtetet pjesëmarrëse për të mbështetur procesin e tranzicionit demokratik.

Më 1994, KSBE-ja e ndryshoi emrin në Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për t'i pasqyruar më me përpikëri këto ndryshime. Që nga ajo kohë, Organizata ka vijuar të zhvillohet për t'iu përgjigjur më mirë kërcënimeve dhe sfidave të sigurisë, ndërsa mbetet e mbështetur fort në parimet e themelimit të saj.



# Si punojmë

Gjithëpërfshirja përshkon gjithçka që bën OSBE-ja. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së gëzojnë status të barabartë dhe i marrin vendimet me konsensus.



OSBE-ja është organizatë ndërqeveritare, ku 57 Shtetet pjesëmarrëse të saj punojnë si të barabarta në të gjitha organet vendimmarrëse.

## Organet vendimmarrëse

Çdo javë, përfaqësuesit e përhershëm të Shteteve pjesëmarrëse takohen në Këshillin e Përhershëm, i cili është organi i rregullt vendimmarrës i OSBE-së, si edhe në Forumin e Bashkëpunimit për Sigurinë, ku merren vendime për aspektet ushtarake të sigurisë. Një Këshill Ministror mbahet çdo vit për të shqyrtuar veprimtaritë e OSBE-së dhe për të dhënë drejtimin e përgjithshëm politik. Samite të krerëve të shteteve apo të qeverive të Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së mund të zhvillohen, në mënyrë periodike, për të caktuar përparësitë në nivelin më të lartë politik.

## Kryesia e OSBE-së

OSBE-ja kryesohet, çdo vit, nga një Shtet pjesëmarrës i ndryshëm. Ministri i Jashtëm i atij shteti shërben si Kryetar i Radhës dhe punon bashkë me Kryesinë paraardhëse dhe atë pasardhëse: së bashku, të tria Kryesitë formojnë Trojkën

e OSBE-së. Kryetari i Radhës mund të emërojë përfaqësues personalë. Aktualisht, ka përfaqësues personalë që mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh, nga parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve në rajonin e OSBE-së, të sigurimi i bashkërenditjes në fusha specifike si barazia gjinore dhe rinia, e deri të nxitja e tolerancës dhe mosdiskriminimit.

## Sekretariati

I zgjedhur nga Këshilli Ministror për një mandat trevjeçar, Sekretari i Përgjithshëm drejton Sekretariatin me seli në Vjenë dhe mbështet drejtpërdrejt Kryesinë e OSBE-së. Përveç funksioneve administrative, Sekretariati ka në përbërje edhe Qendrën për Parandalimin e Konflikteve, si edhe departamente të njësi që fokusohen në veprimtari ekonomike dhe mjedisore, bashkëpunimin me vendet dhe organizatat partnere, barazinë gjinore, antitrafikimin, si dhe kërcënimet transnacionale.

Ato monitorojnë prirjet, japin ekspertizë dhe zbatojnë projektet në terren.

## Institucionet

OSBE-ja ka në përbërje tri institucione të specializuara.

## Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)

e vendosur në Varshavë, përkrah zhvillimin demokratik dhe të drejtat e njeriut. Puna e saj përfshin vëzhgimin e zgjedhjeve, mbështetjen e shtetit të së drejtës, nxitjen e tolerancës dhe mosdiskriminimit, si edhe përmirësimin e situatës së romëve dhe sintëve. ODIHR-i organizon Mbledhjen e Zbatimit të Dimensionit Njerëzor, që është konferenca vjetore më e madhe e të drejtave të njeriut në rajonin e OSBE-së.

## Përfaqësuesi për Lirinë e Medias

, me seli në Vjenë, vëzhgon zhvillimet e medias dhe bën paralajmërime të hershme për shkeljet e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias,

duke nxitur respektimin e plotë të të gjitha angazhimeve të OSBE-së për lirinë e medias.

## Si instrument për parandalimin e konflikteve, Komisioneri i Lartë për Pakicat

**Kombëtare**, me seli në Hagë, përdor diplomacinë e qetë dhe veprimin e shpejtë për të kërkuar zgjidhjen e tensioneve etnike, që mund të vënë në rrezik paqen, sigurinë dhe stabilitetin.

## Asambleja Parlamentare

Asambleja Parlamentare mbledh mbi 300 ligjvënës nga parlamentet e Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, për të çuar përpara synimet e OSBE-së për siguri gjithëpërfshirëse përmes dialogut ndërparlamentar. Parlamentarët e OSBE-së luajnë një rol kyç edhe në veprimtaritë e Organizatës për vëzhgimin e zgjedhjeve, bëjnë vizita në terren dhe angazhohen në diplomacinë parlamentare.

# Çfarë bëjmë

OSBE-ja i qaset sigurisë në mënyrë gjithëpërfshirëse, përmes tri dimensioneve: politiko-ushtarak, ekonomik e mjedisor dhe dimensionit njerëzor.

Përmes kësaj qasjeje tridimensionale, OSBE-ja mbështet Shtetet e saj pjesëmarrëse në rritjen e besimit dhe në punën drejt një komuniteti sigurie euroatlantik dhe euroaziatik të lirë, demokratik, të përbashkët dhe të pandashëm.

Në **çështjet ushtarake**, OSBE-ja synon të krijojë më shumë hapje, transparencë dhe bashkëpunim, dhe ka zhvilluar regjimin më të

përparuar në botë në lidhje me masat e **kontrollit të armëve dhe ndërtimit të besimit**. Fushat e punës përfshijnë reformën në sektorin e sigurisë, si edhe magazinimin dhe shkatërrimin e sigurt të armëve të vogla, armëve të lehta dhe municionit konvencional.

Edhe **çështjet ekonomike e mjedisore** janë faktor kyç në rritjen e sigurisë. OSBE-ja ndihmon përmes **përkrahjes së mirëqeverisjes; luftës**

**kundër korrupsionit, rritjes së ndërgjegjësimit mjedisor**, përdorimit të përbashkët të burimeve natyrore dhe menaxhimit të shëndoshë të mbetjeve mjedisore.

**Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore** janë themelet e shoqërive të qëndrueshme. OSBE-ja i ndihmon Shtetet e saj pjesëmarrëse të ndërtojnë institucione demokratike; të zhvillojnë **zgjedhje** të vërteta dhe transparente; të garantojnë respektimin e të drejtave të njeriut, **lirisë së medias, të drejtave të pakicave kombëtare dhe shtetit të së drejtës**; si edhe **nxit tolerancën dhe mosdiskriminimin**.

OSBE-ja trajton, gjithashtu, edhe sfidat e sigurisë

transnacionale, si **ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që çojnë në terrorizëm; sulmet kibernetike; migracionin; trafikimin e drogave, të armëve dhe personave**; si edhe **ndikimin mjedisor e njerëzor të ndryshimit të klimës**. Këto janë çështje të përbashkëta, për të cilat shtetet duhet të punojnë së bashku.

OSBE-ja punon ngushtë me organizatat e tjera ndërkombëtare dhe rajonale, si edhe bashkëpunon me vendet partnere të Mesdheut dhe Azisë (Partnerët për Bashkëpunim). Ajo përfshin shoqërinë civile në shumë veprimtari të saj dhe, gjithnjë e më shumë, i afrohet një game të gjerë partnerësh të tjerë, përfshirë botën akademike dhe sektorëve privatë e zhvillues.

## Degët e shumta të punës së OSBE-së





# Në terren

Pjesa më e madhe e stafit dhe burimeve të OSBE-së janë të vendosura në operacione në terren, në Evropën Juglindore, Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore.

Duke njohur se shkollat janë vend i shkëlqyer për të ushqyer besimin e përbashkët, për të prishur stereotipet dhe për të zgjeruar njohuritë rreth të drejtave universale të njeriut, OSBE-ja angazhohet në mënyrë aktive me fëmijët, të rinjtë dhe me mësuesit.



Operacionet në terren krijohen me ftesë të vendeve pritëse, dhe mandatet e tyre përcaktohen me marrëveshje me konsensus të Shteteve pjesëmarrëse. Ato mbështesin vendet pritëse për të zbatuar angazhimet e tyre në kornizën e OSBE-së, përmes projekteve, që u përgjigjen nevojave specifike. Disa operacione në terren si Misioni i Posaçëm Monitorues në Ukrainë, i cili përfshin mbi 1 300 personel civil, mes të cilëve mbi 740 monitorues, punojnë për të ulur tensionet. Të tjera luajnë një rol kritik pas konflikteve, duke ndihmuar në rivendosjen e mirëbesimit mes bashkësive të prekura nga konflikti.

Një nga veprimtaritë thelbësore të OSBE-së është adresimi i konflikteve të zgjatura, në rajonin e saj, sipas formateve të negociatave të dakordësuara. Këtu futen Procesi për Zgjedhjen e Konfliktit Transdnestrian, që synon arritjen e një zgjidhjeje politike gjithëpërfshirëse të konfliktit për Transdnestrian; Grupi i Minskut i OSBE-së, i cili kërkon zgjidhje paqësore të negociuar për konfliktin Nagorni-Karabak; si edhe Diskutimet Ndërkombëtare të Gjenevës, pas konfliktit të gushtit 2008, në Gjeorgji, të cilat Organizata i bashkëdrejton me Kombet e Bashkuara dhe me Bashkimin Evropian.



OSBE-ja vëzhgon zgjedhjet dhe këshillon qeveritë se si të zhvillojnë dhe mbështesin institucionet demokratike.



Media e pavarur dhe profesioniste është gur themeli i shoqërive demokratike dhe element kyq i punës së OSBE-së.



Përkrahja e policimit profesionist dhe të efektshëm është pjesë përbërëse e përpjekjeve të OSBE-së për parandalimin e konflikteve dhe rehabilitimin pas konflikteve.



OSBE-ja, me anë të operacioneve në terren, ndihmon në ndalimin e përhapjes së armëve të tepërta dhe ofron ndihmë për shkatërrimin e tyre.

# Struktura e OSBE-së

## Organet vendimmarrëse

### Samiti

Mbledhjet e krerëve të shteteve apo qeverive të Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së vendosin përparësi, marrin vendime dhe ofrojnë orientim në nivelin më të lartë politik. Samiti i fundit i OSBE-së u mbajt në Kazakistan, më 2010.

### Këshilli Ministror

Mbledhja vjetore e ministrave të Jashtëm të Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së është organi qendror vendimmarrës dhe qeverisës i OSBE-së.

### Këshilli i Përhershëm

Këshilli i Përhershëm është organi i rregullt i OSBE-së për dialog politik dhe vendimarrje, në të cilin mbledhen, çdo javë, në Vjenë, përfaqësuesit e përhershëm të Shteteve pjesëmarrëse.

### Forumi për Bashkëpunimin për Sigurinë

Forumi është organ vendimmarrës autonom, ku përfaqësuesit e Shteteve pjesëmarrëse takohen çdo javë për t'u konsultuar rreth stabilitetit dhe sigurisë ushtarake.

### Asambleja Parlamentare e OSBE-së

Asambleja Parlamentare e OSBE-së përbëhet nga mbi 300 deputetë nga të 57-a Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Ajo ofron një forum për dialog parlamentar, drejton misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve, angazhohet në diplomacinë parlamentare dhe fuqizon bashkëpunimin ndërkombëtar për çështje të lidhura me OSBE-në.

### Përfaqësuesit Personalë të Kryetarit të Radhës

Përfaqësuesit Personalë ngarkohen nga Kryesia që të punojnë për të parandaluar dhe menaxhuar konfliktet në rajonin e OSBE-së, për të siguruar bashkërendimin në fusha të posaçme, si çështjet gjinore dhe rinore, si edhe për të nxitur tolerancën dhe mosdiskriminimin.

### Kryetari i Radhës/Kryesia e OSBE-së

Çdo vit, një Shtet pjesëmarrës i ndryshëm kryeson OSBE-në, dhe ministri i Jashtëm i atij vendi vepron si Kryetar i Radhës. Kryesia e OSBE-së bashkërendon vendimarrjen dhe vendos përparësitë e OSBE-së për atë vit.

### Trojka

Trojka përbëhet nga përfaqësues të Kryesisë së tanishme, asaj të mëparshme dhe Kryesisë së ardhshme.

## Strukturat ekzekutive

### Sekretari i Përgjithshëm / Sekretariati, Vjenë

I zgjedhur për një mandat trevjeçar nga Këshilli Ministror, Sekretari i Përgjithshëm kryeson Sekretariatin e OSBE-së në Vjenë dhe vepron nën udhëzimet e Kryetarit të Radhës.

### Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Varshavë

ODIHR-i përkrah zgjedhjet demokratike, respektimin e të drejtave të njeriut, shtetin e së drejtës, tolerancën dhe mosdiskriminimin, si edhe të drejtat e komuniteteve rome e sinti.

### Përfaqësuesi për Lirinë e Medias, Vjenë

Përfaqësuesi vëzhgon zhvillimet e medias në të 57-a Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, dhe bën paralajmërim të hershëm për shkeljet e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias.

### Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare, Hagë

Roli i Komisionerit të Lartë është të bëjë paralajmërim të hershëm dhe të ndërmarë veprime të hershme të përshtatshme për të parandaluar përshkallëzimin e tensioneve etnike në konflikte.

## Operacionet e OSBE-së në terren

Operacionet e OSBE-së në terren mbështetnin vendet pritëse në zbatimin e angazhimeve të tyre në kornizën e OSBE-së dhe për të forcuar kapacitetet vendase me anë të projekteve konkrete që u përgjigjen nevojave të tyre. Operacionet në terren i mundësojnë OSBE-së që të trajtojnë krizat sapo lindin dhe të mbështetë rehabilitimin pas konfliktit.

### Evropa Juglindore

- Prezenca në Shqipëri
- Misioni në Bosnjë-Hercegovinë
- Misioni në Kosovë
- Misioni në Mal të Zi
- Misioni në Serbi
- Misioni në Shkup

### Evropa Lindore

- Misioni në Moldavi
- Bashkërenduesi i Projekteve në Ukrainë
- Misioni i Posaçëm Monitorues në Ukrainë
- Misioni Vëzhgues në Pikat Ruse të Kontrollit në Gukovo dhe Donjeck

### Kaukazi Jugor

- Përfaqësuesi Personal i Kryetarit të Radhës së OSBE-së për konfliktin e trajtuar me Konferencën e Minskut e OSBE-së

### Azia Qendrore

- Qendra në Ashkabat
- Zyra e Programeve në Nur-Sultan
- Zyra e Programeve në Bishkek
- Zyra e Programeve në Dushanbe
- Bashkërenduesi i Projekteve në Uzbekistan

## Organet e lidhura me OSBE-në

### Grupi i Përbashkët Konsultativ

Ky organ, me qendër në Vjenë, trajton çështjet në lidhje me respektimin e dispozitave të Traktatit për Forcat e Armatosura Konvencionale në Evropë.

### Komisioni Konsultativ për Qiejt e Hapur

Ky organ mbledhet rregullisht në Vjenë dhe përbëhet prej përfaqësuesve të secilit prej 34 Shteteve Palë, që kanë nënshkruar Traktatin e Qiejve të Hapur.

### Gjykata e Pajtitimit dhe Arbitrazhit

Kjo gjykatë, me qendër në Gjenevë, shërben si mekanizëm për zgjidhjen paqësore të konflikteve, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me angazhimet e OSBE-së.

# Fakte dhe shifra

(shtator 2019)

Shifrat e përditësuara i gjeni në faqen: [www.osce.org/whatistheosce/factsheet](http://www.osce.org/whatistheosce/factsheet)

## Buxheti:

### 139 milion euro

Buxheti i OSBE-së për vitin 2019

Nuk përfshin financimin:

### 102.4 milion euro

për Misionin e Posaçëm Monitorues të OSBE-së në Ukrainë dhe Misionin Vëzhgues të OSBE-së në Pikat Ruse të Kontrollit në Gukovo dhe Donjeck

### 45 milion euro

për projektet jashtëbuxhetore apo të posaçme

## Stafi:



### 3,603 persona të punësuar nga OSBE-ja

staf i përhershëm, përfshirë stafin e financuar nga kontribute jashtëbuxhetore

I përbërë nga:

### 2,999 pjesëtarë stafi

në **16 operacionet e OSBE-së në terren** në Evropën Juglindore, Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore

### 604 pjesëtarë stafi

në **Sekretariat** dhe në **institucione**, të marra së bashku

## Balanca gjinore:



Raporti ndërmjet grave dhe burrave në poste të ndryshme në OSBE

	Burra	Gra
Stafi i përgjithshëm	52%	48%
Stafi profesionist	63%	37%
Stafi menaxhues	75%	25%
<b>Totali</b>	<b>58%</b>	<b>42%</b>

## Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së

Shqipëria

Andorra

Armenia

Austria

Azerbajxhani

Bjellorusia

Belgjika

Bosnjë-Hercegovina

Bullgaria

Kanadaja

Kroacia

Qiproja

Republika Çeke

Danimarka

Estonia

Finlanda

Franca

Gjeorgjia

Gjermania

Greqia

Selia e Shenjtë

Hungaria

Islanda

Irlanda

Italia

Kazakistani

Kirgistani

Letonia

Lihtenshtajni

Lituania

Luksemburgu

Malta

Moldavia

Monako

Mongolia

Mali i Zi

Vendet e Ulëta

Maqedonia e Veriut

Norvegjia

Polonia

Portugalia

Rumania

Federata Ruse

San-Marino

Serbia

Sillovakia

Slovenia

Spanja

Suedia

Zvicra

Taxhikistani

Turqia

Turkmenistani

Ukraina

Mbretëria e Bashkuar

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Uzbekistani

## Partnerët për Bashkëpunim

Afganistani

Australia

Japonia

Republika e Koresë

Tajlanda

Algjeria

Egjipti

Izraeli

Jordania

Maroku

Tunizia

## Ndiq OSBE-në:



Vendet e lira të punës dhe mundësitë për internship botohen rregullisht në faqen e internetit të OSBE-së: [jobs.osce.org](http://jobs.osce.org)

Për më shumë informacion rreth OSBE-së, punës dhe strukturave të saj, vizitoni faqen e internetit: [osce.org](http://osce.org)

OSCE Sekretariat  
Wallnerstrasse 6  
A-1010 Vienna, Austria  
Tel.: +43 1 514 36 6000  
[pm@osce.org](mailto:pm@osce.org)



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë